



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 13.12.2024

Më datë 13 Dhjetor u zhvillua online mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat (KKN). Axhenda e takimit ishte:

1. Miratimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të rishikuar, NVE Rev 2.1;
2. Prezantimi mbi rishikimin e Nomenklaturës së Konsumit Individual sipas Qëllimit, COICOP

Kryetarja e KKN, Znj. Elsa Dhuli hapi takimin dhe bëri prezantimin e rendit të ditës i cili u miratua pa ndryshime nga anëtarët. Takimi vijoi sipas axhendës.

Miratimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të rishikuar, NVE Rev 2.1

Z. Maldi Dema, bëri një përmbledhje të përmbajtjes së projekt aktit i cili rrjedh në zbatim të nenit 24 të ligjit për statistika zyrtare dhe ngarkon komisionin e KKN-së të kryej përditësimin dhe përshtatjen e klasifikimeve statistikore. Për efekt të ligjit komisioni i nomenklaturave e përgatit, e shqyrton si dhe e përshtat sipas kushteve dhe definicioneve të vendit tonë, duke ja kaluar më tej Këshillit të Ministrave për transformimin e tij në dokument ligjor. Miratimi i projekt aktit është miratuar nga komisioni sipas komunikimeve dhe janë marrë parasysh inputet që institucionet kanë dhënë. Gjithashtu komentet e ardhura në lidhje me dokumentin e nomenklaturës së NVE rev 2.1 janë diskutuar me versionin e përkthyesit të certifikuar. Z. Dema u ndal në komentin e fundit të ardhur nga Ministria e Bujqësisë. Disa nga sugjerimet janë marrë parasysh dhe disa komente duke u konsultuar me stafin e INSTAT si dhe me përkthyesin e certifikuar nuk janë marrë parasysh.

Në vijim Z. Dema prezantoi dhe dokumentacionin që do ti bashkëngjitet nomenklaturës, përkatësisht projekt-vendim për miratimin e nomenklaturës NVE Rev 2.1.

E ftuar në takim ishte dhe përfaqësuesi nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për të marrë një mendim ose për të shqyrtuar mekanikën se si do të vijoj më tej përshtatja

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

e nomenklaturës në sistemet teknologjike. Znj. Sonja Sinorukaj, përfaqësuese nga AKSHI bëri një sugjerim në lidhje me pikën 6 të projekt-vendimit. Institucioni AKSHI nuk është përgjegjës për të dhënat që kanë sistemet e institucioneve në administratë. Pra pika e 6 në projekt-vendim nuk duhet të jetë e tillë që ngarkohet AKSHI për këto integritime. AKSHI do jetë mbështetje teknike në procesin e integritimeve. Një përgjigje zyrtare do i vihet në dispozicion INSTAT mbi ndryshimin e kësaj pike. Sekretariati do të reflektojë në projekt-vendim mënyrën se si do shprehet roli i AKSHI-t në procesin e integritimit të nomenklaturës së NVE Rev 2.1.

Znj. Dhuli vijoi më tej takimin. Ndër të tjera ajo solli në vëmendje që Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është institucioni i parë për ndërmarrjet e reja të krijuara. Me grupet e ngushta teknike të punës do të diskutohet se si do të kryhet vendosja e kodeve të reja tek stoku i bizneseve që është pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Duhet të nis një herë kodifikimi i ndërmarrjeve të reja sepse stoku i ndërmarrjeve kërkon një kohë dhe angazhim relativisht më të gjatë për shkak të listës së madhe të ndërmarrjeve në fjalë.

Sipas rregullores së Bashkimit Evropian, parimi i vendosjes së kodit të aktivitetit është vendosja fillimisht e kodit të aktivitetit në të cilën realizohet përqindja më e lartë e xhiros nga vetë biznesi. Vet biznesi duhet të vendosë kodin e aktivitetit bazuar në pritshmëritë e tij se nga cili aktivitet projekton të ketë xhiron më të madhe.

Pas miratimit të nomenklaturës do planifikohen trajnime me stafin e QKB dhe DPT, pjesë e së cilave do jenë gjithashtu përfaqësues nga AKSHI. Mund të krijohet dhe një video informuese për biznesin për të ardhur në ndihmë gjatë vendosjes së kodit të aktivitetit. INSTAT do të vendosë në dispozicion nomenklaturën NVE Rev 2.1 për institucionet, në formatet që ata e kërkojnë.

Përfaqësusi nga QKB, me pozicion përgjegjës i IT, Z. Klodian Mazari informoi komisionin që institucioni DPT po bën ndryshime në sistemet e tij. DPT duhet të jap një konfirmim kur është gati për të vijuar me procesin e integritimit të nomenklaturës. Si institucione që janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën duhet dhe në këtë proces të ecin njëkohësisht. Z. Mazari shtoi që përveç QKB është dhe Agjencia e Prokurimit Publik e cila furnizohet me informacion nga QKB si dhe bashkitë.

Znj. Dhuli theksoi dhe një herë që nomenklatura do të kalojë paralelisht të gjitha institucioneve që janë të parat për implementimin e nomenklaturës si dhe do të zhvillohen trajnime (në dy faza) për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e implementimit të nomenklaturës së rishikuar, NVE Rev 2.1.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit pranë INSTAT do të jetë në komunikim të vazhdueshëm dhe në lidhje të ngushtë me përgjegjësit e IT në institucionet përkatëse, në mënyrë që dokumenti të dërgohet në formatin e nevojshëm.

Znj. Dhuli propozoi që viti 2025 të shërbejë si periudhë tranzicioni për të menaxhuar problematikat që mund të dalin në vazhdimësi të procesit (pas miratimit nga KM), ndërkohë që 6-mujori i parë i vitit 2026 të konsiderohet si periudhë për zbatimin final, pra integrimin e kodeve të reja në të gjithë sistemet. Ky propozim u mirëprit dhe nga anëtari i pranishëm nga DPT.

Nga ana anëtarëve të KKN-së u miratuan në parim projekt aktet për nomenklaturën NVE rev 2.1.

Prezantimi mbi rishikimin e Nomenklaturës së Konsumit Individual sipas Qëllimit, COICOP

Znj. Dhuli vijoi takimin në lidhje me rishikimin e Nomenklaturës së Konsumit Individual sipas Qëllimit, COICOP. Një nga detyrimet për kapitullin 18 “Statistika” është dhe rishikimi i nomenklaturës COICOP. Nomenklatura përdoret në anketën e buxhetit të familjes, në indeksin e çmimeve të konsumit, në indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit si dhe në llogaritë kombëtare për llogaritjen e produktit të brendshëm bazuar në konsumin e familjes.

INSTAT do të paraqes një relacion mbi rëndësinë e nomenklaturës dhe arsyet pse duhet të implementohet versioni i ri i tij. Nomenklatura është miratuar nga Kombet e Bashkuara dhe i zbatuar në mënyrë unanime nga të gjithë vendet e BE-së. Në planin e punës që do të diskutohet në mbledhjen e parë të komisionit në vitin 2025 do të prezantohen të gjitha aktivitetet që do të kryhen për implementimin e COICOP.

Znj. Anisa Omuri, Drejtoreshë e Drejtorisë së Statistikave Sociale pranë INSTAT bëri një prezantim më të detajuar mbi nomenklaturën COICOP. Ndër të tjera ajo informoi anëtarët se COICOP siguron një kuadër të përbashkët mbi klasifikimin e shpenzimeve të konsumit të njësive ekonomik familjare (NjEF), duke grupuar produktet, mallrat dhe shërbimet sipas qëllimeve specifike, me frekuenca të ndryshme të mbledhjes së informacionit. Zbatimi i COICOP daton prej vitit 1923, duke u përmirësuar vazhdimisht për të adresuar ndryshimet në modelet e konsumit. COICOP 2018 është miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2018 dhe nga BE-ja në rregulloren ESA 2010. Gjatë vitit 2025, INSTAT do të mbështetet teknikisht për zbatimin e COICOP 2018 në:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

ridizenjimin e pyetësorit si dhe në krijimin e infrastrukturës statistikore duke mundësuar lidhjen e COICOP 2012 me 2018. Transmetimi i të dhënave me COICOP 2018 do të fillojë në vitin 2026 për të qënë të përputhshëm me rekomandimet e Eurostat-it.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN

24 Dhjetor 2024

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al